

VENDIM
Nr. 640, datë 7.9.2016

**PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË
SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)¹**

(ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 12.4.2017, nr. 98, datë 23.2.2018)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në bashkitë Kavajë, Fier, *Tiranë, Krujë, Gjirokastrë dhe Shkodër.*

2. Për një periudhë kohe deri në konsolidimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve, ky shërbim do të ofrohet, njëkohësisht, nga ADISA dhe FSDKSH-ja.

3. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 7.9.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 14 shtator 2016.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 12.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 20 prill 2017.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 23.2.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 2 mars 2018.